



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 859/ 5 prot.

Datë 27.03.2026

V E N D I M
Nr. 437/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.03.2026 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh për Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik të Impiantit Boville për vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

Autoriteti Kontraktor: SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë..

Ankimues: Operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k me NIPT L41629009A, dhe adresë: Rruga Pavaresia Ndërtesa Nr. 1, Kati i Trete, Zyra 340 dhe magazine, Mezez.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05-01-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh

dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.2. Në datën 23-01-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05-03-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me vlerë 6.490.000 lekë skualifikuar (Në përgjigje të këtij njoftimi, me shkresën nr. 3610 prot., datë 26.02.2026, operatori ekonomik “Carpathia Albania sh.p.k.” dorëzoi pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e sipërcituar. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e realizimit të kontratës për kontratën e ngjashme, dokument i kërkuar në kuadër të përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Ky dokument përbën një element thelbësor për të provuar përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik në realizimin e kontratave të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi. Mungesa e këtij dokumenti nuk mundëson verifikimin e plotë të përmbushjes së kriterit për përvojë të mëparshme dhe, për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk arrin të provojë përmbushjen e këtij kriteri të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik “Carpathia Albania sh.p.k.” nuk përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, për rrjedhojë, skualifikohet nga procedura e prokurimit. Në vijim të procedurës dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vijojë me verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik të renditur në vendin pasardhës në klasifikimin e ofertave.)

2. OE “ISOMETRIC” SHPK	me vlerë 6.643.985	lekë kualifikuar
3. OE “ALBUJI” SHPK	me vlerë 7.280.000	lekë kualifikuar
4. OE “GAMMA” SHPK	me vlerë 7.300.000	lekë kualifikuar
5. OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK	me vlerë 7.346.566,50	lekë kualifikuar
6. OE “KRIJON” SHPK	me vlerë 7.346.566,50	lekë kualifikuar
7. OE “KEJ Group” SHPK	me vlerë 7.351.355	lekë kualifikuar
8. OE “Skyline SC” SHPK	me vlerë 8.331.086	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 13.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 17.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 859/2026 protokoli, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “*CARPATHIA ALBANIA*” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “*Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025*”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.859/1 prot, datë 18.03.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*CARPATHIA ALBANIA*” sh.p.k, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet postës, ka përcjellë shkresën nr. 19468/13 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me nr.859/2 prot., datë 27.03.2026, ku vrehet se ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*CARPATHIA ALBANIA*” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar e cila është dërguar edhe nëpërmjet postës elektronike Autoritetit kontraktor, rezulton, se ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*CARPATHIA ALBANIA*” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*CARPATHIA ALBANIA*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së praqitur prej tyre, me arsyen se: “*Ky dokumentacion përbën provë të qartë, të plotë dhe të pakontestueshme të përvojës së mëparshme, duke përmbushur të gjitha kërkesat e dokumenteve të tenderit. Është e rëndësishme të theksohet se procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje me hapat standardë, ku pas vlerësimit elektronik, shoqëria Carpathia Albania sh.p.k. ËSHTË KUALIFIKUAR DHE RENDITUR SI OFERTUES I SUKSESSHËM paraprak në bazë të ofertës ekonomike. Në vijim të njoftimit për fituesin paraprak, Autoriteti Kontraktor kërkoi dorëzimin fizik*

të dokumentacionit provues, i cili u dorëzua brenda afatit të përcaktuar, konkretisht më datë 26.02.2026, me Nr. 3610 Prot., duke përfshirë të gjithë dokumentacionin e paraqitur më parë në mënyrë elektronike në APP sipas DST dhe gjithashtu dhe njëherë shkresën e Kthim-Përgjigjes bashkëlidhur kontratat, procesverbale pranimit dhe dorëzimi, akte dorëzimi, faturat elektronike dhe vërtetime nga institucionet publike, duke dokumentuar në mënyrë të plotë realizimin e kontratave të ngjashme dhe përmbushjen e kriterit të kualifikimit. Megjithatë, pavarësisht përmbushjes së plotë të kërkesave dhe dorëzimit korrekt të dokumentacionit, shoqëria u skualifikua në një fazë të mëvonshme të procedurës, për arsye të pakuptuara dhe të pabazuara, duke qenë se i gjithë dokumentacioni i kërkuar ka qenë i rregullt, i plotë dhe në përputhje me kriteret e kualifikimit. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktor pasi në sistem ka pranuar dokumentacionin provues ka vendosur të skualifikojë shoqërinë tonë me arsyetimin se nuk ka paraqitur vërtetim për realizimin e kontratave të ngjashme. Ky arsyetim është absolutisht i pabazuar dhe i padrejtë, pasi dokumentacioni provues u dorëzua në mënyrë të plotë dhe brenda afateve të përcaktuara dhe është pranuar, duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe dokumentacionin e tenderit. Ky vendim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin dhe parimet e prokurimit publik, duke dëmtuar rëndë konkurrencën e ndershme dhe duke penguar përzgjedhjen e ofertës më të favorshme. Gjithashtu, oferta e shoqërisë sonë ishte oferta më e ulët me vlerë 6,490,000 (gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, duke e bërë atë ekonomikisht më të favorshmen për Autoritetin Kontraktor. Skualifikimi i operatorit ekonomik me ofertën më të ulët dhe që ka dorëzuar dokumentacionin e plotë paraqet një përfitim të paligjshëm për një operatorin pasardhës, duke shkelur parimet e barazisë dhe proporcionalitetit në procedurën e prokurimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, është parashikuar si më poshtë vijon:

“2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “Carpathia Albania” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Vertetim nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin nr.112 prot., datë 12.02.2026 që është realizuar me sukses procedura “Blerje kite dhe reagent”.
- Kontrata furnizimi Nr. 20358 Prot., datë 01.10.2025, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe shoqërisë Carpathia Albania sh.p.k., me objekt furnizimin Blerje materiale dhe reagent laboratorikë ;
- Procesverbal pranimit/dorëzimit datë 20.11.2025 dokumenton pranimin e mallrave sipas kontratës;
- Procesverbal datë 24.12.2025 dokumenton përfundimin e dorëzimit të pjesës tjetër të furnizimit;
- Procesverbal datë 16.01.2026 dokumenton dorëzimin përfundimtar të mallrave në institucionin kontraktues;
- Akt dorëzimi datë 20.01.2026 konfirmon përmbushjen e të gjithë kontratës;
- Kopje të faturave elektronike përkatëse, të cilat konfirmojnë pagesat;
- Kopje të faturave elektronike përkatëse, të cilat konfirmojnë pagesat;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin

vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Sa më sipër, referuar kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket dëshmive për furnizimet e mëparshme të ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, konstatojmë, se referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky operator ekonomik pas kërkesës së autoritetit kontaktor datë 12.02.2026 për dokumentacionin shtesë provues pas dhënies së indicies nëpërmjet faturave tatimore për plotësimin e kriterit 2.3.1, pasi deri në atë moment ishin dorëzuar vetëm faturat për furnizimet e mëparshme të ngjashme operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin duke provuar furnizimet e mëparshme të ngjashme sikurse cituar në pikën III.1.2 të këtij vendimi dhe sikurse kërkuar edhe nga autoriteti kontaktor. Pas këtij momenti procedural autoriteti kontaktor ka kualifikuar operatorin ekonomik ankimues për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht në SPE.

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhej procedura e prokurimit objekt-ankimi dhe arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “...se pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e realizimit të kontratës për kontratën e ngjashme, dokument i kërkuar në kuadër të përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Ky dokument përbën një element thelbësor për të provuar përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik në realizimin e kontratave të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi. Mungesa e këtij dokumenti nuk

mundëson verifikimin e plotë të përmbushjes së kriterit për përvojë të mëparshme dhe, për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk arrin të provojë përmbushjen e këtij kriteri të kërkuar nga autoriteti kontraktor...”, autoriteti kontraktor e kishte kryer vlerësimin e kësaj faze/momenti procedural dhe e ka kualifikuar operatorin ekonomik për kriterin 2.3.1 dhe pas kualifikimit në këtë fazë është kërkuar dorëzimi i dokumentacionit fizik ku Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje se dokumentacioni referuar kriterit 2.3.1 nuk është ndër dokumentat që i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, poltesohen me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se dokumentacioni provues i dorëzuar ne SPE me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të shtojcës 8, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE ankimues “Carpathia Albania” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues “Carpathia Albania” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73589-12-31-2025, me objekt “Blerje reagentesh dhe pajisjesh per Labororet fiziko-kimik dhe bakteriologjik te Impiantit Boville per vitin 2025”, me fond limit 9,795,422.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23-01 2026 , nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

